

SKEDE TEKNIKE



FM 031

PERSHKRIMI I PRODUKTIT

FM 031: Ngjitës me bazë çimento, për ngjitjen e pllakave qeramike. Është klasifikuar si C1TE sipas EN 12004, baza C çimento, 1 ngjitës me forcë ngjitëse normale, T antirreshkitshmëri, E kohë e zgjatur punimi.

- Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm në ambiente banimi.
- Punueshmëri e mirë.
- Për fiksimin e qeramikës në sipërfaqe me bazë çimento.
- Për fiksime qeramike në sipërfaqe gipsi pasi është trajtuar me PRIMER.

Rekomandime rreth përdorimit

Përdoret për shtrimin e pllakave qeramike, pllaka të dimensioneve të vogla në sipërfaqe të ndryshme të tilla si: beton, dysheme me bazë çimento e suva. Ky produkt është i përshtatshëm për ambiente të brendshme.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri / Bardhe
Pesha volumore	1550 kg/m ³
Koha e punimit	2 ore
Koha e punueshmerise	30 min
Koha e korrektimit	35 min
Forca ngjitese ne kushte normale	0.92 N/mm ²
Forca ngjitese pas zhytjes ne uje	0.75 N/mm ²
Forca ngjitese pas reagimit te nxehtesise	0.89 N/mm ²
Forca ngjitese pas cikleve ngrirje-shkrirje	0.82 N/mm ²

Udhëzime mbi aplikimin

Metoda e aplikimit: Malle metalike

Holluesi: Uje

Raporti i Hollimit: 25 – 26 % v/v

Udhezime mbi aplikimin

Përgatitja e sipërfaqes Suportet tradicionale me bazë çimento duhet të kenë një kohë maturimi të mjaftueshme prej (28 ditë në temperaturë 23o C dhe U.R 40%). Suportet duhet të jenë të sheshta dhe të qëndrueshme në funksion të qëllimit të përdorimit. Suporti ku do të aplikohet produkti duhet të jetë i pastër, pa lëndë të huaja të tilla si: bojra, vajra, verniqe, materiale antingjitëse. Pastrimi bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Suvatë përpara aplikimit të produktit duhet të kenë një maturim prej të paktën 1 javë për 1 cm trashësi. Suportet duhet të jenë mekanikisht të qëndrueshëm në funksion të qëllimit të përdorimit. Sipërfaqja e suportit ku do të aplikohet produkti duhet të jetë e pastër nga çdo lloj lënde e huaj.

Për një aplikim sa më të mirë të produktit si dhe për të përfutur një shpërndarje më të mirë dhe uniforme në të gjithë sipërfaqen, rekomandohet që fillimisht shtrimi i produktit mbi suport të bëhet me pjesën e drejtë të mallës, e më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Produkti duhet të aplikohet me një mallë të përshtatshme në varësi të tipit dhe përmasave të pllakës. Rekomandohet që mbas vendosjes së pllakës, të ushtrohet presion mbi të në mënyrë që pjesa e pasme të laget plotësisht. Në kushte të veçanta si: temperaturat e larta apo erërat e forta, dielli apo substrate me një absorbim të lartë të ujit që ndikojnë negativisht në performancën e produktit madje mund të ulin në mënyrë të ndjeshme kohën e hapjes dhe të korrektimit. Në rastin e veshjeve dhe dysHEMEVE në ambiente të jashtme, sidomos në rastet kur pjesa e pasme e pllakave është me relief, këshillohet që ngjitësi të përhapet edhe në pjesën e pasme të pllakës edhe në suport në mënyrë që të mos krijohen zgavra (kavitete) në të cilat mund të penetrojë uji apo të formohet lagështi, të cilat mund të shkaktojnë më pas shqitjen ose edhe thyerjen e pllakave.

PAKETIMI

Thasë letre prej 25 Kg

RUAJTJA/MAGAZINIMI

12 muaj, kur është i ruajtur në mjedis normal dhe paketim origjinal, të mbrojtur nga ekspozimi direkt ndaj diellit dhe acarit.

INFORMACIONI MBI SHENDETIN, SIGURINE DHE MJEDISIN

Referojuni informacionit që permbajne etiketat e ambalazheve. Ne raste specifike, kur kerkohet informacion shtese, referojuni Skedes se Te Dhenave Mbi Materialet e Sigurise.

